



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 110 datë 04.12. 2025

PËR DHËNIE TITULLI “ QYTETAR NDERI I PËRMETIT ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m, Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr.558 datë 20.11.2025 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

VENDOSI:

1 – T’i japë titullin “Qytetar Nderi i Përmetit” Z.Illir Ohri me motivacionin :

“ Për kontribut të shquar në kujdesin shëndetësor në fushën e mjekësisë, për vlerat e larta për mbrojtjen e shëndetit në komunitet dhe shpirtin e paepur të sacrificës, për aftësi të jashtëzakonshme për punën në skuadër, për kushtimin, profesionalizmin dhe humanizmin që e karakterizon.

2 - Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

